SHDPAK
FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

# Raport Vjetor

# 2009

## Raport Vjetor 2009

# MISIONI

**Promovim të shanseve të barabarta dhe mbrojtje të vazhdueshme të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre**

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Design & Layout: Orest Muça

© Copyright FSHDPAK

Për më tepër informacion kontaktoni:
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
Rruga BOGDANI, P.15, Kati i 3-të, Tiranë
Tel/Fax: + 355 42 269 426
www. adrf.org.al
e-mail: adrf@albmail.com

# FSHDPAK merr çmimin e Lidershipit për Shoqërinë Civile, 2009

Në vitin 2009, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara fitoi Çmimin “Lidershipi për Shoqërinë Civile”. Që prej vitit 2004, Co-Plan ka iniciuar dhe vazhdon të organizojë ofrimin e cmimit “Lidershipi Shqiptar” për 1 përfaqsues/subjekt në 4 fusha: Shoqëri Civile; Qeverisje; Media dhe Shtypi; Sektori Privat/ Biznesi; Çmimi Special.
FSHDPAK e fitoi këtë cmim për fushën e shoqërisë civile me dedikimin: *“Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara bën pjesë në atë grupim organizatash jo-fitimprurëse, të cilat falë punës, arritjeve dhe përkushtimit kanë zënë një vend të respektuarnë “odeonin” e publikut të gjerë dhe sidomos komuniteteve të cilave ju shërbejnë. Gjatë këtyre 13 viteve aktivitet, Fondacioni ka arritur të përfaqësojë dhe advokojë suksesshëm në emër të personave me aftësi të kufizuar dhe së bashku me ta të sjellë një ndryshim të prekshëm për mentalitetin e shoqërisë shqiptare në drejtim të:*

- *Lobimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për të gjitha kategoritë e aftësive të kufizuara, duke ndikuar drejtëpërdrejtë në rritjen e aksesit të këtyre kategorive në shoqëri;*
- *Rritjes së mobiliteteit të personave me aftësi të kufizuar, duke qënë praktikisht i vetmi institucion public dhe jopublik që plotëson në nivel të konsiderueshëm nevojat e kësaj kategorie me mjete lëvizëse; duke ndikuar drejtpërdrejtënë rritjen e mundësive të tyre për integrim social;*
- *Përfaqësimit ligjor, këshillimit, trajnimit dhe punësimit me transparencë për këtë kategori sociale në nevojë”.*


“LIDERSHIPI SHQIPTAR”
2009

ÇMIMI LIDERSHIP PËR SHOQËRINË CIVILE

i jepet:

Fondacionit Shqiptar
për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

**Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizu**
bën pjesë në atë grupim organizatash jo-fitimprurëse të cilat falë pun
arritjeve dhe përkushtimit kanë zënë një vend të respektuar në ‘odeon
e publikut të gjerë, dhe sidomos komuniteteve të cilave u shërbejnë.

Gjatë këtyre 13 viteve aktivitet, Fondacioni ka arritur të përfaqësojë dhe advokojë suksesshëm në emër të personave me aftësi të kufizuar dhe së bashku me ta të sjellë një ndryshim të prekshëm për mentalitetin e shoqërisë shqiptare në drejtim të:

- Lobimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për të gjitha kategorit aftësive të kufizuara, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e aksesit këtyre kategorive në shoqëri.
- Rritjes së mobilitetit të personave me aftësi të kufizuar, duke q praktikisht i vetmi institucion publik dhe jopublik që plotëson nivel të konsiderueshëm nevojat e kësaj kategorie me mjete lëvizë duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e mundësive të tyre për integ social.
- Përfaqësimit ligjor, këshillimit, trajnimit dhe punësimit me transparencë për këtë kategori sociale në nevojë.

Për Co-PLAN
Dritan SHUTINA
Drejtori Ekzekutiv

# Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri

Me mbështetjen e USAID-it, projekti "Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve në Shqipëri" do të mbështesë prodhimin/pajisjen me karrige me rrota dhe do të sigurojë trainimin për personat në nevojë, por ajo që është më e rëndësishme përsa i përket zbatimit të këtij projekti është që ai do të jetë i rëndësishëm për krijimin e kushteve të nevojshme për siguruar qëndrueshmërinë e këtij shërbimi në Shqipëri.

Në vitin 2009, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) organizoi aktivitete bazuar në planin të aktiviteteve. Aktiviteti kryesor i programit ishte sigurimi i karrigeve me rrota, informacionit të nevojshëm, dhe trainimit për personat në nevojë për karrige me rrota përmes prodhimit të tyre në punishten e prodhimit të karrigeve me rrota "Mirësia" të FSHDPAK. Mbështetja kishte të bënte me modelimin dhe prodhimin e 25 karrigeve me rrota të një stili aktiv (të palosura/ose jo)/në muaj bazuar në vlerësimet dhe kërkesat individuale të personave me aftësi të kufizuar. Procesi i prodhimit të karrigeve me rrota kalon përmes tri fazave, që janë Vlerësimi/ Modelimi i karrigeve me rrota/ Prodhimi si dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse. Pas procesit të identifikimit koordinatori i shperndarjes kryen procesin e vleresimit dhe matjet bazuar në formularin tip në përputhje me nevojat individuale të personit me aftësi të kufizuar. Me pas nis procesi i prodhimit të karriges me rrota.

Gjatë periudhës së raportimit janë mundësuar vlerësimet/porositë individuale për 202 karrige me rrota. Vlerësimi ka patur lidhje me grupmosha dhe rajone të ndryshme të vendit.

Me marrjen e karrigeve me rrota, përfituesit dhe familjarët e tyre mbështeten edhe me informacion dhe trainimin e nevojshëm për kujdesin personal shëndetësor, fizioterapi dhe aftësi të tjera për

përdorimin e karriges me rrota. Personat me aftësi të kufizuar që do të përfitojnë karrige me rrota falë këtij projekti do të jenë më të përfshirë në jetën shoqërore, jo vetëm brenda shtëpive të tyre duke lehtësuar kështu të afërmit e familjarët e tyre, por edhe jashtë duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme edukative dhe sociale të komunitetit të tyre.

Një nga objektivat kryesore të këtij projekti është ai që ka të bëjë me krijimin përmes aktiviteteve të avokatisë të një mjedis me qëllimin final që shërbimi i prodhimit dhe ofrimit të karrigeve me rrota për personat me aftësi të kufizuar të bëhet i qëndrueshëm në Shqipëri.
Për realizimin e këitj objektivi, gjatë periudhës së raportimit, një ndër ndërhyrjet kryesore të FSHDPAK, në përputhje me planin e aktivitetit të projektit, ka qenë lobimi, përfshirja dhe ekspertiza teknike që i është ofruar qeverisë shqiptare për përpilimin dhe miratimin e dispozitave të nevojshme juridike/ administrative për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij shërbimi.
2(dy) propozime ligjore (karriget me rrota/ndryshime të tjera në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale) dhe 1 (një) propozim/ dokument për analizën e kostove të karrigeve me rrota tashmë janë përgatitur, paraqitur dhe diskutuar në disa takime të organizuara me institucionet përkatëse shtetërore, si; Ministrinë e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Kujdesit të Sigurimeve Shëndetësore.
Në vazhdimësi gjatë vitit 2009, janë organizuar takime me autoritetet kryesore publike të cilat përgjigjen për hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore për sigurimin e karrigeve me rrota për personat në nevojë në Shqipëri.
FSHDPAK ka lobuar për përfshirjen dhe angazhimin e qeverisë shqiptare në hartimin dhe miratimin e dispozitave të nevojshme ligjore/ administrative për të garantuar qendrueshmërinë e shërbimit.
Në takimet me Drejtoreshën e Përgjithshme të Institutit të Kujdesit Shëndetësor, Ministrin e Shëndetësisë, zyrtarë të lartë të Ministrisë së Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtorin e Politikave Sociale; juristë dhe specialistë të këtyre institucioneve u diskutua mbi rëndësinë e një sistemi të qendrueshëm për sigurimin e karrigeve me rrota. Argumentet e sjella në këto takime ishin në përputhje me dialogun e mëparshëm, duke ritheksuar edhe një herë nevojën për të rregulluar kuadrin ligjor që do të garantonte të drejtën e individit me aftësi të kufizuar për lëvizje, në mënyrë që të garantonte gjithashtu përputhjen me standardet e BE-se dhe ato ndërkombëtare, në vecanti me Konventen e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (UN CRPD) e miratuar se fundmi nga shteti shqiptar.

# Politika dhe Aftesia e Kufizuar

Projekti “Promovim i ndryshimit në platformat politike përmes dialogut, ndërmjet personave me aftësi të kufizuar dhe politikanëve” i mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, synoi të nxiste pjesmarrjen e qytetarëve me aftësi të kufizuar në vendimarrjet për çështje të rendësishme, duke ndërgjegjësuar drejtues dhe anëtarë të partive politike për atë se si përgjegjësitë e tyre si të zgjedhur lidhen me zgjidhjen e problematikave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.
Si një iniciativë e para e këtij lloji në Shqipëri, projekti mori përsipër dhe realizoi një studim vëzhgimi për vlerësimin se Sa dhe Si partitë politike në Shqipëri reflektojnë në programet e tyre politike dhe elektorale nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe problematikat e tyre; sa ato njohin kuadrin politik dhe ligjor vendas dhe ndërkombëtar në mbështetje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar; qëndrimet e tyre për pjesmarrje të PAK në jetën politike të vendit si dhe perspektiva e tyre për zgjidhje të problematikave të PAK si; punësimi, arsimi, përshtatshmëria, shërbimet sociale – shëndetësore, e drejta e votës. Në fokus të studimit u përzgjodhën 4 parti politike; PD, PS, PDK dhe LSI bazuar në spektrin politik që ato përfaqësojnë si dhe % të përfaqësimit të tyre në parlament. Studimi nxorri rekomandime konkrete të cilat u bënë te njohura për të gjithe aktorët e përfshirë në projekt në dy seminaret e organizuara. (www.adrf.org.al). Të dhënat e raportit u bënë prezent për publikun perms kronikave të TV Top – Chanel, Top News, TVSH, TV Koha, TV News 24, TV Vizion +.
Ndërgjegjësimi i spektrit politik të përfshirë në projekt për; problematikën e aftësisë së kufizuar; të drejtat e personave me aftësi të kufizuar; kuadrin ligjor ekzistues në Shqipëri si dhe politikat aktuale qeverisëse në mbështetje të tyre qe një objektiv tjetër themelor i projektit. Informacioni i përgatitur

dhe shpërndarë per perfaqësues të katër partive politike, trainimet e zhvilluara me pjesmarrjen e perfaqesuesve të katër partive politike të përfshira në projekt me tematikë kryesore “ Aftësia e kufizuar dhe Barazia”, modul i cili përfshinte trajtimin e çështjeve të tilla si; etika dhe terminologjia për aftësine e kufizuar, modeli social si favorzues ndaj atij mjekësor, te drejtat e njeriut dhe aftësia e kufizuar, qenë instrumentat e përdorur për të mundësuar njohjen e përfaqësuesve të politikës politkës me problematikën e aftësisë së kufizuar dhe vlerësimin e saj si çështje e të drejtave të njeriut. Projekti synoi dhe realizoi gjithashtu të nxisë dhe inkurajojë individë me aftësi të kufizuar përfaqësues të organizatave aktive në fushën e aftësisë së kufizuar për të rritur interesin dhe përpjekjet e tyre për të qenë pjesë aktive e dialogut politik për vendimarrjet ne fushën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri si dhe të mundësojë ngritjen e




kapaciteteve të tyre për të qënë në një të ardhme të afërt pjesë e politikës shqiptare. Trainimi 5 ditor i zhvilluar me përfaqësues të përzgjedhur nga organizta aktive të fushës së aftësisë së kufizuar me tematika komunikin, lidershipin, ndërtimin e partnershipeve dhe dialogut si dhe avokati për pjesmarrje aktive në politikë mundësuan krijimin e nje grupi të personave me aftësi të kufizuar të informuar dhe me potenciale aktive për të lobuar dhe negociuar me faktorin politik për çështje të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Zbatimi i projektit ishte një mundësi e mirë për kontakte të vazhdueshme dhe të organizuara me spektrin politik në vend për ti ndërgjegjësuar ata për problematikat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri si dhe problematika adekuate në përputhje me zhvillimet politike dhe ligjore të ndodhura në kohën kur projekti gjeti zbatim. Takimet me drejtues të grupeve parlamentare, Kryetarë të Komisioneve parlamentare për Cështjet ligjore ato të Reformës Zgjedhore, Drejtues të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve krijuan mundësi për vendosjen e një dialogu konstruktiv. Kjo u mundësua me marrjen në konsideratë të shumë sygjerimeve dhe rekomandimeve të dërguara në formën e korespondencës pranë këtyre institucioneve.

# Hapa të mëtejshëm për një zhvillim gjithpërfshirës

Koalicioni Shqiptar - Aftësia e Kufizur dhe Zhvilimi, mbështetur nga World Learning Forecast / USAID, vijoi edhe gjatë vitit 2009 aktivitetet e tij për të realizuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit në Shqipëri.

Aktiviteti u fokusua në një fushatë te vazhdueshme avokatie e lobimi për mbrojtjen e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara; kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar mendore; për të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara; u shoqërua me takime të përfaqësuesve të DDCA me drejtues të institucioneve përgjegjëse.

U zhvillua një takim i DDCA, në prill 2009, me pjesmarrjen e te gjithe anetareve..

Në këtë takim, dy të ftuar nga KQZ, bënë prezente tek pjesëmarrësit masat që KQZ po ndërmerrte, në përgjigje të thirrjes së DDCA, për të siguruar pjesëmarrjen në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara në zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Një takimi dytë, i hapur i DDCA, u zhvillua në Dhjetor 2009.

Në këtë takim fokusi u vendos në sigurimin e të drejtës për arsim gjithpërfshirës të fëmijëve më aftësi të kufizuara, si nisëm e Save the Children dhe Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në të morën pjesë 30 anëtarë dhe të ftuar ishin drejtues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si edhe studentë të fakultetit të shkencave sociale, për të cilët diskutimet e zhvilluara shërbyen si një leksion i hapur.

U përgatitën dhe shpërndanë dy edicione te Buletin informativ. U përgatit dhe funksionon faqja e internetit e DDCA www.ddca-al.org.

# Fondacioni Vodafone-Albania mbështet integrimin aktiv të personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota



Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Vodafone – Albania në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2009 ka realizuar zbatimin e këtij projekti i cili ka kontribuar ndjeshëm dhe drejtpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë së jetës së 180 personave me aftësi të kufizuar, duke e rritur numrin e përfituesve të mbështetur nga VFA në vite në 710 përfitues,si dhe ka rritur shanset e tyre për integrim në komunitet. Personat me aftësi të kufizuar, përfitues të karrigeve me rrota kanë qënë kryesisht nga zonat veriore të vendit si; Malësi e Madhe, Laç, Lezhë, Mirditë, Shkodër si dhe nga Tirana, Elbasani dhe Librazhdi.

Zbatimi i projektit gjatë vitit 2009, ka mundësuar pajisjen me karrige me rrota të personave me aftësi të kufizuar edhe nga zonat veriore; Malësi e Madhe dhe Mirditë të pambuluara nga projektet e zbatuara më parë me mbështejen e VFA.
Personat me aftësi të kufizuar të pajisur me karrige me rrota kanë marrë pjesë gjithashtu edhe në Kampin e Rehabilitimit Aktiv, pjesë e zbatimit të këtij projekti, organizuar në Tetor 2009 në kompleksin Mak Albania-Durrës. Ky kamp u ka shërbyer përfituesve të rinj për tu pajisur me njohuri dhe aftësi praktike për përdorimin aktiv të karriges me rrota, orientim drejt një jete sa më të pavarur, asistencë ligjore dhe psikologjike.
Projekti ka shërbyer në vazhdimësi edhe si një model i



mirë për tu replikuar edhe nga donatorë të tjerë pasi ka ofruar krahas aktiviteteve të mësipërme edhe punësimin e 5 personave me aftësi të kufizuar në fabrikën "Mirësia" (program i FSHDPAK) të angazhuar drejtpërsëdrejti në prodhimin e karrigeve me rrota.

# Shkëmbime eksperiencash në rajon

Përfaqësues të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe përfaqësues të disa prej institucioneve të administratës publike, morrën pjesë në një trajnim-vizitë studimore, një javore gjatë muajit Prill 2009, të organizuar nga Motivation-Romania dhe financuar nga USAID- World Learning FORECAST/ programi Shqipëri. Trajnimi kishte për qëllim përfitimin e njohurive teorike dhe praktike mbi aspekte të arritjes së qëndrueshmërisë për prodhimin e karrigeve me rrota në Shqipëri. Pjesmarrësit në trajnim patën mundësinë për të diskutuar së bashku mbi elementët për hartimin e politikave efektive të asistencës sociale, me qëllim mbështetjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuar për karrige me rrota si dhe identifikimin e elementeve efektivë për ngritjen e fondeve për prodhimin e karrigeve me rrota në Shqipëri. Gjithashtu, ky trajnim shërbeu edhe për identifikimin dhe diskutimin e politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore, si një nga skemat efektive për sigurimin e mbështetjes të individëve me aftësi të kufizuar në nevojë për karrige me rrota. Drejtuesja ekzekutive, përfaqësuesja ligjore, inxhinjeri si dhe koordinatorja për ngritjen e fondeve pranë FSHDPAK, përfaqësuesja e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta dhe Presidenti i Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të Punës hartuan një plan veprimi për ndërhyrje në nivel qëndror/ vendor me qëllim fuqizimin e qëndrueshmërisë dhe mbështetjen e përdoruesve të karrikeve me rrota nga strukturat përgjegjëse.



# Federata Ndërkombëtare e Tenisit, mbështet zhvillimin e sportit të tenisit në karrike me rrota ne Shqipëri

Federata Ndërkombëtare e Tenisit në bashkëpunim me Federaten Shqiptare te Tenisit dhe me ondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, prej disa muajsh, po punojnë për zhvillimin e sportit të tenisit në karrike me rrota në Shqipëri. Prej disa muajsh, një grup të rinjsh, përdorues të karrikeve me rrota, po luajnë nën drejtimin e dy trajnerëve të Federatës Shqiptare të Tenisit, në ambjentet ku kjo Federatë zhvillon aktivitetin e saj. Personat me aftësi të Kufizuara kanë të drejtën të luajnë dhe të argëtohen. Përmes sportit, ato mund të krijojnë aftësi sociale, të mësojnë si të fitojnë dhe humbasin, të shprehin potencialet e tyre sportive me synimin dhe ambicjen për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë edhe në gara, apo kampionate lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të ndihmuar në ofrimin e teknikave të lojës së tenisit në karrike me rrota, Federata Ndërkombëtare e Tenisit, përmes këtij projekti të mbështetur nga Silver Fund, mundësoi ardhjen në Shqipëri gjatë muajit Shtator, të Geraint Richards, për të organizuar sëbashku me trajnerët shqiptarë, një trajnim intensiv 5 ditor me grupin e të rinjve me aftësi të kufizuara. Përmes këtij aktiviteti, Federata Shqiptare e Tenisit, hap dyert dhe krijon akses për shërbimet e saj, edhe ndaj personave me aftësi të kufizuar, duke ofruar një model të një programi gjithpërfshirës zhvillimi. Federata Shqiptare dhe ajo Ndërkombëtare e Tenisit, sebashku me lojtarët me aftësi të kufizuara kanë ambicje dhe synime të cilat mendojnë t'i realizojnë gjatë vitit 2010.

# Infrastrukturë dhe Transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara

**Në kuadër të projektit "Infrastrukturë dhe Transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara", mbështetur nga Fondacioni i Shoqërise së Hapur për Shqipërinë gjatë vitit 2009, FSHDPAK synoi në nxitjen e procesit të realizimit të përshtatshmërisë në mjedis dhe transport për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.**

Në kuadër të projektit u zhvillua një seminar kombëtar si edhe dy debate televizive, një në TV Skampa Elbasan dhe një në News 24 Tiranë.

FSHDPAK përgatiti dhe zhvilloi më 6 Nëntor 2009, Seminarin Kombëtar "Ndërtime dhe transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara". Në seminar morën pjesë 57 persona; përfaqësues të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të prefekturës Tiranë e Durrës, përfaqësues qarqesh, përfaqësues të bashkisë Tiranë, njësive bashkiake Tiranë dhe bashki të tjera të vendit, universiteti Polis, specialistë të urbanistikës e transportit.

Në seminar morën pjesë edhe përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar. Pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht në lidhje me hapat që janë bërë për zbatimin e legjislacionit duke prezantuar arritje e mosarritje e duke nxjerrë përgjegjësitë. Pjesëmarrësit propozuan edhe rekomandime konkrete për të nxitur zbatimin e legjislacionit për përshtatshmërinë ndërtimore, duke u fokusuar në rolin e pushtetit vendor.

U zhvilluan dy debatet televizive në News 24 dhe në TV Skampa Elbasan. Këto ishin emisionet e para ku u debatua vetëm për problemin e përshtatshmërisë në mjedise dhe transport. Përmes debateve të realizuara u prezantua dhe u bë i njohur niveli i arritur i legjislacionit shqiptar në fushën e përshtatshmërisë për specialistët përgjegjës në institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor; për specialistët/ biznesmenë në fushën e ndërtimeve; për përfituesit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

# Ndërtimi i një mjedisi pa barriera dhe e drejta e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës




Në Janar 2009 u zhvillua Konferenca Kombëtare "Ndërtimi i një mjedisi pa barriera dhe e drejta e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës" me mbështetjen e World Learning Forecast / USAID, Ministria e Punëve Publike,Transportit e Telekomunikacionit, në bashkëpunim dhe FSHDPAK. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të strukturave përgjegjëse, qëndrore e vendore dhe aktorë të tjera nga sektorët publikë dhe të biznesit. FSHDPAK luajti një rol të veçantë në mbështetje të MPPTT për organizimin e kësaj konference si edhe gjatë zhvillimit të saj, duke orientuar diskutimet në gjetjen e zgjidhjeve për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

# Promovim dhe Mbrojtje e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri

Gjate periudhës Janar 2009-Mars 2010, Komisioni Europian në kuadrin e Instrumentit Europian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut, mbështeti FSHDPAK për zbatimin e projektit me fokus promovim dhe mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Përmes këtij projekti, FSHDPAK synoi të nxisë zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara nga insitucionet përgjegjëse.

Trajnimet, seminaret, fushatat ndergjegjesuese, konsulenca në vazhdimësi nga profesionistë të fushës, ku një vend të veçantë zunë vetë personat me aftësi te kufizuara, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në adaptimin e strategjisë në plane veprimi për



zbatimin e saj në nivel lokal.
Në 3 Dhjetor 2009, Diten ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK në kuadrin e e këtij programi, organizoi hapjen e ekspozitës “ Kaq e vështirë, sepse…”.
Për realizimin e saj, u punua ngushtë me individë me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre, me organizata dhe ofrues shërbimesh ne fushën e aftësisë së kufizuar. Një rol i rëndësishëm, për pergatitjen dhe organizimin e ekspozitës, ishte dhe ai i fotografes Jutta Bezzenberg,
Kjo ekspozitë përbën një risi në pasqyrimin e problematikës së mprehtë me të cilën ndeshen sot në Shqipëri personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.
Me anë të saj, FSHDPAK synoi të hedhë dritë në realitetin shqiptar të personave me aftësi të kufizuar duke sjellë copëza nga jeta e vështirësitë e përditshme me të cilat ata ndeshen.
Ekspozita u ndoq nga shumë të




ftuar, perfaqsues nga institucionet shtetërore, nga trupi diplomatik në Shqipëri, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, përfaqsues nga biznesi, individë me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, komuniteti i biznesit etj.
Gjatë muajit Dhjetor, kjo ekspozitë u hap edhe ne qytetet e Korcës dhe Shkodrës.
Me kërkesë të Këshillit Britanik, në Shqipëri, disa nga fotot e paraqitura në ekspozitë, janë vendosur dhe do të qëndrojnë në ambjentet e zyrave të tyre, për një periudhë tre mujore.
Një nga ndërhyrjet më të rëndësishme të këtij projekti ishte monitorimi i zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pesronave me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2 vjecarëe 2008/2009.
Monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë Kombëtare te Personave me Aftësi te Kufizuara nga Shoqëria Civile, synon te nxisë llogaridhënien e Qeverise Shqiptare, te rrisë ndjenjën e pergjegjesise dhe përkushtimin e agjencive qeveritare dhe jo qeveritare për përfshirjen e problematikes se aftësisë se kufizuar ne axhendat e reformave, për te sfiduar ne ketë mënyre përjashtimin social dhe për te promovuar gjithëperfshirjen.

# Avokati dhe mobilizim social për ratifikimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara




Në Qershor 2009, përmes një granti nga Rrjeti i Fondacioneve te Shoqërisë së Hapur, FSHDPAK filloi zbatimin e një projekti të fokusuar në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, krijimin e kapaciteteve te OJFve dhe gjithë aktorëve të tjerë përmes trajnimeve, espertizës teknike dhe konsulencës së ofruar nga profesionistë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut, si edhe përdorimin e mekanizmave efetivë të lobimit dhe avokatisë për të përshpejtuar ratifikimin dhe zbatimin e Konventës se OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Përpjekjet e FSHDPAKsë për zbatimin e projektit, u fokusuan në realizimin e një sërë aktiviteteve, ku nga më të rëndësishmet do të veconim:

Trajnim per trajnere "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuar". Gjate muajit Tetor 2009 u realizua trajnimi 3 ditor ToT me teme "Konventa e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ndërgjegjësim, instrumentat për

ratifikimin dhe monitorim". Ne te moren pjese 15 anëtarë dhe drejtues të organizatave që punojnë në fushën e aftesise te kufizuar, si dhe te rinj me aftësi të kufizuar lider dhe aktivistë të të drejtave te njeriut. Moduli i trajnimit 3 ditor kishte per qellim pregatitjen e pjesmaresve me njohuritë teorike dhe praktike mbi konceptet bazë dhe instrumentat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimit të diskriminimit; njohjen me përmbajtjen e Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar; instrumentat e ratifikimit dhe monitorimit të saj; njohjen e pjesmaresve me mjetet e avokatisë që mund te përdoren nga shoqëria civile për nxitjen e procesit të ratifikimit dhe më tej për zbatimin e saj nga Qeveria Shqiptare. Trajnimi u realizua nga dy ekspertet e stafit te FSHDPAK dhe Z. Simon Walker, Këshilltar për të drejtat e njeriut-Koordinator në Zyrën e UN Tiranë. Po keta trajnere u perfshine ne nje trajnim me perfaqesues te Medias se shkruar dhe elektronike, organizuar ne Tirane, me synim ndergjegjesimin




e gazetarëve mbi këtë dokument të rëndësishëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe koordinimit të punës së FSHDPAK me ta, në një proces të vazhdueshëm ndergjegjesues dhe avokues, në nxitje të ratifikimit dhe zbatimit të Konventës nga shteti shqiptar.

Pjesmarrësit e pregatitur në ToT 3 ditor, u përfshinë nga FSHDPAK ne një seri te gjerë trajnimesh mbi "Konventen e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, me anëtarë të OJF të njerëzve me aftësi të kufizura në 12 rajone të Shqipërisë.

Në kuadrin e këtij programi në datë 10.11.2009, FSHDPAK organizoi Konferencën kombëtare "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuar, lobim dhe avokati për ratifikim" Qëllimi i kësaj konference ishte ndërgjegjësimi i gjithë aktorëve përgjegjës në nivel kombëtar dhe rajonal me këtë instrument të ri ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut,

aprovuar më 13.12.2006 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve te Bashkuara, si dhe me domosdoshmërinë për ratifikimin e këtij dokumenti nga Qeveria Shqiptare. Ne kete konference nje vend të veçantë zuri prezantimi i dy ekspertëve nderkombetare, Z. Simon Walker, Këshilltar për të drejtat e njeriut- Koordinator në Zyrën e UN Tiranë, dhe Zj. Marianne Schulze, Këshilltare për të drejtat e njeriut-GTZ. Prezantimet nga 2 aktivistet lokalë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ofruan një përshkrim realist ë ndikimit që do të ketë ratifikimi i Konventës në garantimin e të drejtave themelore, ende të munguara për to dhe komunitetin që ato parfaqësojnë në Shqipëri.Ndërkohë që hapat që duhet të ndërmarrë Shteti Shqiptar dhe detyrimet për zbatimin e kësaj konvente u prezantuan nga ekspertët e Ministrisë të Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Ministrisë të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB). Një pjesë të rëndesishme të diskutimit ndërrmejt pjesmarrësve zuri draft-plani i masave i prezantuar nga dy ekspertët, me synim përshpejtimin e procesit të ratifikimit të kësaj konvente nga Qeveria Shqiptare.

Realizimi i kësaj konference dhe lobimi i vazhdueshëm i FSHDPAK që prej fillesave të hartimit të këaj konvente nga OKB, u finalizua me nënshkrimin në parim të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuara nga Qeveria Shqiptare në 03.12.2009, dhe nënshkrimin e saj nga Ambasadori i Shqipërisë në New York në 22 Dhjetor 2009.

FSHDPAK do të vazhdojë një proces intensiv ndërgjegjësimi përmes fushatave mediatike, fushatave të avokatisë dhe lobimit mbi adresimin e cështjeve të konsideruara prioritare nga komunitei i njerëzve me aftësi të kufizuara, duke përdorur si instrument Konventën e OKBsë për të drejtat e tyre, për ratifikimin e së cilës gjithashtu po lobohet ndjeshëm nga FSHDPAK.



# Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe barazia gjinore

Në nëntor të vitit 2008 USAID-i i ofroi Fondacionit Shqiptar të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) një grant, me qëllim nxitjen e integrimit të grave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit, njëherazi duke i fuqizuar dhe rritur aftësitë e tyre profesionale për advokaci, lobim dhe lidership.

Granti ka ndihmuar në krijimin e dy lëvizjeve të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar, e para "Gratë dhe Vajzat Intelektuale me Aftësi të Kufizuar" dhe e dyta "Klubi i Grave", me qëllim nxitjen e aksesit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar në arsim, punësim, dhe në jetën sociale, ekonomike dhe politike në nivel kombëtar, dhe në vecanti në zonën veriore të vendit, në Shkodër.

Përmes takimeve intensive, periodike, anëtaret e këtyre grupimeve ngritën problematika, përgatitën një draft platformë për




qeverinë, me rekomandime të nxjerra nga analiza e gjendjes së grave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Cështjeve Sociale




dhe Shanseve të Barabarta, FSHDPAK botoi një studim të vecantë, me titull ˝Gratë me Aftësi të kufizuara- Të përfshira apo të harruara?˝. Në këtë botim bëhet një vlerësim i përfshirjes së të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në dokumentat e politikave shqiptare, që fokusohen në arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, studimi bën një vlerësim të përfshirjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar në strategjitë, programet dhe veprimtaritë e organizatave të fushës së barazisë gjinore dhe të të drejtave të aftësisë së kufizuar. Në muajin maj të vitit 2009, FSHDPAK organizoi Konferencën e parë në rang Kombëtar për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe instancave përkatëse në lidhje me nevojën për hartimin e një plani kombëtar veprimi, dhe një strategjie lobimi dhe advokacie për trajtimin e problematikave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Në verën e vitit 2009 u organizua një fushatë gjithëpërfshirëse multi mediatike për të ofruar imazhe pozitive dhe për të përmirësuar informacionin dhe për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e njeriut, dhe në vecanti të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara.

# Respektimi i të drejtave elektorale për personat me aftësi të kufizuara

Mbështetur dhe në bashkëpunim me IRI - Institutin Republikan Ndërkombëtar, FSHDPAK ka vazhduar përpjekjet për përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në programet politike dhe elektorale të subjekteve zgjedhore, duke punuar edhe me organizata të personave me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër FSHDPAK, ka zhvilluar fushata intensive avokatie, lobimi e ndërgjegjësimi përmes takimeve në nivelet më të larta të vendimarrjes dhe ekzekutivit, të strukturave zgjedhore, të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të 28 Qershorit 2009; përmes korespondencës së vazhdueshme me këto subjekte; përmes deklaratave dhe prononcimeve në Media. FSHDPAK ofroi bashkëpunimin në organizimin e trajnimit të ekspertit të IRI për ngritjen e kapaciteteve advokuese të organizatave të aftësisë së kufizuara për



t'u përgatitur për zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2009. Përfaqësues të FSHDPAK morën pjesë në takimet që IRI organizoi me Kryeministrin e Shqiperise, Z.Sali Berisha, me kryetarin e KQZ Z. Arben Ristani, gjate te cilave bënë prezente domosdoshmërinë





e zbatimit të Platformës së Aftësisë së kufizuar, veçanërisht për marrjen e masave për krijimin e aksesit për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të Kufizuara.
Takime u zhvilluan gjithashtu nga përfaqësuesit FSHDPAK dhe IRI  me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Çështjeve të Aftësisë së Kufizuar, z. Genc Pollo dhe Ministrin e Brendshem Z. Bujar Nishani, ku u prezantuan synimet  për nxitjen e zbatimit të Kodit Zgjedhor  në lidhje me pjesëmarrjen në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara.
Takime ndërgjegjësuese u zhvilluan edhe me deputetët në komisionet parlamentare.
Dukshmëria në media e problematikës së aftësisë së kufizuar në fushatën para zgjedhore në zgjedhjet e Qershorit 2009 u monitorua nga FSHDPAK, i cili hartoi e  shpërndau një raport te këtij monitorimi.
58 zgjedhës me aftësi të kufizuara (43 femra) u përfshinë në grupin e vëzhguesve, të organizuar nga FSHDPAK  për monitorimin e këtyre zgjedhjeve. Mbi bazën e të dhënave të mbledhura prej tyre u hartua raporti i monitorimit me rekomandimet për strukturat përgjegjëse.
Si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese të FSHDPAK dhe më tej të DDCA,  për herë të parë KQZ planifikoi një fond modest për ndërtimin e 26 rampave në disa objekte publike në Tiranë – qendra votimi, ku votues ishin edhe zgjedhës me aftësi të kufizuara.

# Program i ndihmës ligjore falas Janar 2009 - Janar 2010

Programi i ndihmës ligjore falas vazhdon t'i shërbejë komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, falë mbështetjes së Organizatës "Mbrojtësit e të Drejtave Civile-Civil Rights Defenders".
Misioni i këtij programi është mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, duke u ofruar atyre shërbime ligjore me cilësi të lartë dhe falas nga avokatët që punojnë në pesë rrethe të Shqipërisë, por edhe advokaci të vazhdueshme në nivel qendror dhe vendor për personat me aftësi të kufizuar.
Ajo çka është shumë e rëndësishme për ne është qasja me bazë komunitare. Çdo person me aftësi të kufizuar mund të marrë këshillim ligjor nga juristët tanë, në cdo moment për nevojat më të zakonshme juridike.
Shërbimet bazë që ofrohen janë këshillimet ligjore që përfshijnë konsultimet në zyrë dhe konsultime me telefon, si edhe përpilim të dokumenteve juridike, shkresa apo telefonata nga avokatët tanë ndaj një palë oponente apo ndaj punonjësve të administratës publike. Në gjithashtu ofrojmë mbështetje ligjore dhe përfaqësim në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor shqiptar. Avokatët mund të sigurojnë një kombinim të këtyre shërbimeve, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të rastit.
Gjatë vitit 2009, programi pati një kërkesë të lartë nga personat dhe një larmi rastesh, gjë që tregon dhe konfirmon konsistencën e këtij program dhe nevojën e personave me aftësi të kufizuar për tu fuqizuar dhe për të siguruar më shumë shërbime dhe përfitime.
Është me rëndësi të theksohet se tryezat e rumbullakta, takimet dhe aktivitetet e advokacisë, por edhe puna kërkimore, sondazhet/ monitorimet dhe studimet së bashku kanë qënë një pjesë thelbësore e programit edhe për këtë vit. Falë këtyre iniciativave, këtë vit dhe nëpër vite, hartuesit e politikave i kanë njohur dhe

| Qytetet | Nr. Total i cështjeve | Çështje gjyqësore | Çështje administrative |
|---|---|---|---|
| Tiranë | 265 | 3 | 262 |
| Elbasan | 121 | 1 | 115 |
| Korçë | 103 | 4 | 98 |
| Vlorë | 132 | 3 | 122 |
| Shkodër | 240 | 3 | 213 |
| Total | 861 | 14 | 810 |

pranuar cështjet e aftësisë së kufizuar në Shqipëri përmes përfshirjes së tematikës së aftësisë së kufizuar në legjislacionin e aftësisë së kufizuar sipas standardeve ndërkombëtare. Gjatë vitit 2009, zyra ka trajtuar një numër total prej 861 rastesh, duke përfshirë edhe 14 cështje gjyqësore.

### Aktivitete dhe arritje përmes bashkëpunimit me Programin Ligjor gjatë vitit 2009

- Në muajin janar të vitit 2009, FSHDPAK botoi një Studim mbi Procesin e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri. Ky studim rekomandon ndryshimin e strukturës ekzistuese të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe komisionimin për një kalim nga vlerësimi totalisht mjekësor drejt modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, MPCSSHB-ja është në process të futjes të disa amendamenteve për disa nga dispozitat e ligjit nr. 9355 ku trajtohet gjithashtu edhe komisionimi. FSHDPAK ka bërë rekomandime për amendamente ligjore në lidhje me formën e vlerësimit, si edhe me përbërjen e komisionit që bën vlerësimin.
- FSHDPAK, me iniciativën e GTZ-së dhe Bankës Botërore, në lidhje me reformën e shërbimit të kujdesit shëndetësor ka propozuar përfshirjen në projekt-ligj të mjeteve/pajisjeve mjekësore dhe aksesorëve të aftësisë së kufizuar (karrige me rrota apo pajisje të tjera)si nevoja bazë të personave me aftësi të kufizuar. Rekomandimet janë përpiluar nga eksperti i programit të Ndihmës Ligjore Falas, në përputhje me modelet e vendeve të tjera të Bashkimit Evropian dhe Marrëvëshjen e Stabilizim-Asociimit (të firmosur nga Shqipëria dhe vendet anëtare të BE-së).
- Eksperti ligjor i programit të ndihmës ligjore falas është përfshirë në procesin e hartimit të “Raportit alternative të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve”, një iniciativë kjo e ndërmarrë nga Aleanca e Fëmijëve Shqiptarë e mbështetur nga UNICEF-i. Ekspertiza e FSHDPAK ka konsistuar

kryesisht përsa i përket Nenit 23 "Fëmijët me aftësi të kufizuar" të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve.

- Në mars të vitit 2009, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndërmorri iniciativën për përmirësimin e Dispozitës Normative për fëmijët me aftësi të kufizuar. FSHDPAK është i përfaqësuar nga eksperti/ja i tij ligjor, në grupet e punës, si pjesë e procesit që koordinohet nga Save the Children, Albania.
- Me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 është miratuar "Regullorja për planifikiminn hapsinor për  individët me aftësi të kufizuara". Ky dokument ka për qëllim eleminimin e barrierave arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar. Kjo kishte qënë e detyrueshme, por jo me ligj. Ligji për planifikimin e teritorit i miratuar me VKM të datës 23 prill 2009 përfshin detyrimin për akses në territor dhe në ndërtim.

Është hera e parë që cështja e përshtatshmërisë shprehet në një ligj të përgjithshëm. Deri tani ka patur vetëm disa VKM në lidhje me disa regulla dhe regullore.

- Ligji nr. 10 112 i miratuar me datë 09.04.2009 "Mbi administrimin e pronësisë së përbashkët në ndërtesat rezidenciale" u bënë të mundur personave me aftësi të kufizuar të jetojnë në ndërtesa pa barriera.


362,0
177,1
01-May-09
01-Jun-09
01-Jul-09
01-Aug-09
01-Sep-09
01-Oct-09
01-Nov-09
01-Dec-09
01-Jan-10
01-Feb-10
01-Mar-10
01-Apr-10
01-May-10
01-Jun
01-Nov-10

# Projekte të FSHDPAK gjatë vitit 2009

**(në Euro)**

| | CORDAID | Komisioni Europian | World Learning /USAID | USAID |
|---|---|---|---|---|
| Balanca, 01.01.2009 (bank&cash) | 1,708.50 | 0.00 | 0.00 | 164.20 |
| Te ardhurat | 0 | 62,250.83 | 105,282.45 | 83,783.59 |
| **TOTAL** | **1,708.50** | **62,250.83** | **105,282.45** | **83,947.79** |
| | | | | |
| **Shpenzimet** | | | | |
| | | | | |
| Qera/Blerje zyre ADRF/Mirembajtje/Mallra konsumi | 186.28 | 1,514.75 | 4,027.60 | 2,752.00 |
| Botime/Kancelari/Refreshments/Pajisje zyre | 0.00 | 2,179.86 | 339.95 | 1,635.00 |
| Ndergjegjesim/Reklame/Prodhim Informacioni/Studime/Trajnim | 0.00 | 15,905.21 | 1,037.95 | 43,612.00 |
| Personel | 0.00 | 17,312.10 | 33,856.33 | 26,675.44 |
| Komunikim/E-mail/Internet | 0.00 | 2,935.27 | 760.22 | 3,799.05 |
| Transport/Nafte/Mirembajtje makina&makineri | 0.00 | 1,739.47 | 1,529.62 | 1,891.45 |
| Komisione Bankare | 0.00 | 36 | 281.6 | 309.83 |
| Lende te para & materiale ndihmese | 0.00 | 0.00 | 23,212.12 | 0.00 |
| Dieta/Sherbime Konsulence/Koordinim local/Pagesa trajnim | 1,450.00 | 13,355.49 | 11,632.75 | 3,258.03 |
| | | | | |
| **TOTAL** | **1,636.28** | **54,978.15** | **76,678.14** | **83,932.80** |
| **Balanca 31.12.2009 (bank&cash)** | **72.22** | **7,272.68** | **28,604.31** | **14.99** |

| CRD | GTZ | IRI | Fondacioni Vodafone Shqipëri | MIUSA /USAID | Soros | World Learning Forecast | Soros New York | Ambasada Amerikane | Kontribut Individi | Kontributi i FSHDPAK | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1,150.82 | 0.00 | 119.30 | 16,808.58 | 2,124.98 | 19.00 | 250.48 | 0.00 | 1,453.10 | 0.00 | 28,231.29 | 52,030.25 |
| 47,180.00 | 3,620.40 | 6,808.85 | 20,409.40 | 717.62 | 6,930.40 | 4,675.84 | 26,911.04 | 9,351.16 | 1,577.00 | 14,336.95 | 393,835.53 |
| **48,330.82** | **3,620.40** | **6,928.15** | **37,217.98** | **2,842.60** | **6,949.40** | **4,926.32** | **26,911.04** | **10,804.26** | **1,577.00** | **42,568.24** | **445,865.78** |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| 3,975.73 | 0.00 | 0.00 | 2,891.76 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 560.06 | 473.63 | 0.00 | 8,170.07 | 24,551.88 |
| 6,018.46 | 0.00 | 0.00 | 437.26 | 0.00 | 0.00 | 583.98 | 470.13 | 921.81 | 0.00 | 1,440.00 | 14,026.45 |
| 3,120.58 | 0.00 | 0.00 | 6,681.31 | 0.00 | 5,607.31 | 2,125.45 | 11,579.11 | 4,495.18 | 0.00 | 2,332.12 | 96,496.22 |
| 28,083.10 | 0.00 | 0.00 | 12,976.30 | 0.00 | 861.15 | 1,635.64 | 8,037.43 | 2,841.81 | 0.00 | 3,473.04 | 135,752.34 |
| 2,300.33 | 0.00 | 0.00 | 814.15 | 0.00 | 0.00 | 297.83 | 785.26 | 708.02 | 0.00 | 17.75 | 12,417.88 |
| 2,405.55 | 0.00 | 0.00 | 1,482.71 | 0.00 | 0.00 | 236.13 | 142.36 | 603.31 | 0.00 | 869.09 | 10,899.69 |
| 265.51 | 0.00 | 22.18 | 19.69 | 0.00 | 35.56 | 25.3 | 0.00 | 39.81 | 0.00 | 1,313.03 | 2,348.51 |
| 0.00 | 0.00 | 0.00 | 11,904.79 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 327.93 | 35,444.84 |
| 1,050.00 | 3,619.09 | 6,745.70 | 0.00 | 717.63 | 430.58 | 0.00 | 5,317.62 | 717.63 | 1,577.00 | 888.48 | 50,760.00 |
| | | | | | | | | | | | |
| **47,219.26** | **3,619.09** | **6,767.88** | **37,207.97** | **717.63** | **6,934.60** | **4,904.33** | **26,891.97** | **10,801.20** | **1,577.00** | **18,831.51** | **382,697.81** |
| **1,111.56** | **1.31** | **160.27** | **10.01** | **2,124.97** | **14.80** | **21.99** | **19.07** | **3.06** | **0.00** | **23,736.73** | **63,167.97** |

# Bilanci i F.SH.D.P.A.K

## më 31 Dhjetor 2009 (vlerat në Euro)

| | |
|---|---|
| **AKTIVET** | |
| | |
| ***Aktivet Afatshkurtra*** | |
| Inventar | 33,330.80 |
| Parapagime dhe shpenzime te shtyra | 2,753.15 |
| Mjete monetare | 66,809.57 |
| Aktive totale afatshkurtra | 102,893.52 |
| | |
| ***Aktivet Afatgjata*** | |
| | |
| Aktivet Afatgjata materiale | |
| Toka/ Ndertesa | 269,807.88 |
| Pajisje dhe makineri | 43,065.50 |
| Aktive totale afatgjata | 312,873.38 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | **415,766.90** |
| | |
| **PASIVET DHE KAPITALI** | |
| | |
| ***Pasivet Afatshkurtra*** | |
| Te pagueshme ndaj furnitoreve | 363.78 |
| Te pagueshme ndaj punonjesve | 1,037.53 |
| Detyrime tatimore | 605.56 |
| **Total i pasiveve afatshkurter** | **2,006.87** |
| | |
| ***Pasivet Afatgjata*** | |
| Hua afatgjata | 0.00 |
| **Total i pasiveve afatgjate** | **0.00** |
| | |
| **KAPITALI** | |
| | |
| Fonde te veta | 426,041.85 |
| Fitim (Humbje) e vitit financiar | (12,281.78) |
| **Total i kapitalit** | **413,760.06** |
| | |
| **TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT** | **415,766.93** |

"INTER B.B.K-Auditing" sh p k.

## AUDITOR'S REPORT

To the Executive Director of
**Albanian Disability Rights Foundation**
**Tirana, Albania**

We have audited the accompanying financial statements of Albanian Disability Rights Foundation Tirana - Albania (the Organization), which comprise the statement of financial position as at 31 December 2009 and the statements of comprehensive incomes, statement of changes in fund balance and cash flow statement for the year than ended and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

*Management's Responsibility for the Financial Statements*

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with National Accounting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant go to preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud and error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

*Auditor's Responsibility*

Our responsibility is to express an independent opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. These procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risk of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of the expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

*A member firm of* **Moore Stephens International Limited** *– members in principal cities throughout the world*

"INTER B.B.K-Auditing" sh p k.

*Opinion*

In our opinion, the financial statements give a true and fair view, in all materials respects, the financial position of Albanian Disability Rights Foundation Tirana, as of 31 December 2009, and of its financial position and its cash flows for the year than ended in accordance with Law 9228 dated 29.04.2004 "On Accounting and Financial Statements" and other the Albanian Regulations.

This report is intended solely for the information and use of the organisation's management, the management of donors as requested, and is not intended and should not used by anyone other than these specified parties.

"Inter BBK – Auditing" ltd

Tirana September 24th, 2010

Esmeralda BALLUKU

**Partner**

AUDITING Sh.p.k
INTER B.B.K
TIRANA - ALBANIA

*A member firm of* **Moore Stephens International Limited** *– members in principal cities throughout the world*

## Bordi i FSHDPAK

| | |
|---|---|
| 1. Arjana Haxhiu | Kryetar |
| 2. Virxhil Nano | Anëtar |
| 3. Florian Ballhysa | Anëtar |
| 4. Aferdita seiti | Anëtar |
| 5. Mimoza Bezhani | Anëtar |

## Stafi i FSHDPAK

| | |
|---|---|
| 1. Blerta Drenofci | Drejtore ekzekutive |
| 2. Erdita Brinja | Financiere |
| 3. Florida Kalemi | Koordinatore programi |
| 4. Bardhylka Kospiri | Drejtore programi |
| 5. Narbis Ballhysa | Koordinatore programi |
| 6. Entila Zyba | Koordinatore programi |
| 7. Pilo Miho | Inxhinier, Drejtues i programit të karrigeve me rrota |
| 8. Zija Kulla | Teknik |
| 9. Qederim Hysenaj | Teknik |
| 10. Ruzhdi Pasholli | Teknik |
| 11. Anife Ramaliu | Teknik |
| 12. Halil Greca | Teknik |
| 13. Petrit Kaziu | Shofer |
| 14. Sajmir Grumblleshi | Logjist |
| 15. Luiza Popja | Eksperte ligjore/Elbasan |
| 16. Fatmira Caci | Eksperte ligjore/Vlorë |
| 17. Eftali Xoga | Eksperte ligjore/Korçë |
| 18. Edlira Grabova | Eksperte ligjore/Shkodër |